



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-212/16;
Datë: 26.02.2016 .

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE PËR VITIN 2015

Junik, shkurt 2016

Komiteti për Shërbime Publike në kuadër të Kuvendit të Komunës së Junikut me qëllim të realizimit të detyrave të punës në përputhje me Rregulloren e punës së komiteteve dhe në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale për vitin 2015 harton këtë:

RAPORT P U N E

- Komiteti për Shërbime Publike në mbledhjen e mbajtur me datë 10.01.2015 ka diskutuar mundësinë për gjetjen e një lokacioni i cili do të shërbejë për deponimin e materialeve inerte. Për këtë iniciativë të komitetit u informua edhe Drejtoria për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe në bashkëpunim me komitetin u themelua një komision për sigurimin e një lokacioni adekuat për deponimin e materialeve inerte. Pas një pune intensive të këtij komisioni u caktuan dy lokacione si më të përshtatshme që do të shërbenin si deponi, mirëpo pasi që Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit kërkon kritere strikte për lejimin e kësaj deponie, nuk mundëm që ta realizojmë sepse kërkonte mjete financiare të cilat për momentin për komunën tonë ishin të pa përballueshme. Erdhëm në përfundim që në një të ardhme të afërt prapë të punohet në këtë drejtim;
- KSHP në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 02.03.2015 e shqyrtoj me kujdes punën njëvjeçare të DSHPIMSH-së. Në këtë raport anëtarët e KSHP-së patën rreth mirëmbajtjes së varrezave, gjithashtu vërejtje u paraqitën edhe te prezantimi në vija të trasha në këtë raport, pastaj investimet kapitale në vlerë prej 36.000,00 € nuk ishin të detajizuara. Si shqetësim tjetër ishin pengesat në ndriçimin publik në disa lagje të komunës së Junikut;
- Në mbledhjen e rregullt të KSHP-së të mbajtur më 23.04.2015 u bë shqyrtimi i Planit të punës i DSHPIMSH-së për vitin 2015 dhe kemi ndërhy në rregullimin e këtij plani gjegjësisht ndërhyrje në faqen 3 pika 4 e këtij plani që kishte të bënte me mirëmbajtjen e varrezave të qytetit. Po ashtu në këtë mbledhje u bë edhe shqyrtimi i Planit të punës për mbrojtje nga zjarri për vitin 2015;
- Në mbledhjen e rregullt të KSHP-së të mbajtur më 28.09.2015 u bë përgatitja e Planit të punës së KSHP-së për vitin 2016. Ky plan u përgatit duke pasur bashkëpunim edhe me përfaqësues nga projekti DEMOS, në të cilin plan u përfshinë të gjitha detyrat e parapara me rregullore të punës, dhe ky plan pune iu prezantua me kohë Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim. Gjithashtu u bë edhe shqyrtimi i projekt buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2016;
- Meqenëse me mos pjesëmarrjen e dy anëtarëve të KSHP-së puna e tij u vështirësua në funksionimin normal, atëherë KSHP iu drejtua Kuvendit të Komunës së Junikut me kërkesë për lirimin nga detyra të këtyre anëtarëve dhe zëvendësimin e të njëjtëve me anëtarë të rinj. Kuvendi i Komunës së Junikut në afatin e paraparë ligjorë shqyrtoj dhe miratoj kërkesat e KSHP-së në përputhje me vendimin për themelimin e KSHP-së me ç'rast puna e KSHP-së përsëri u funksionalizua;

- Në mbledhjen e fundit të rregullt për vitin 2015 e cila u mbajt më 17.12.2015 KSHP doli me këto rekomandime për DSHPIMSH:
 1. Rishikimi i shenjave të komunikacionit në rrugët lokale;
 2. Rivendosja e shtyllave elektrike dhe shtyllave për ndriçim publik buzë trotuareve si dhe vendosja e kapakëve të shtyllave;
 3. Pastrimi i brigjeve të rrugëve nga materialet inerte;
 4. Rregullimi i kanalit të ujitjes në lagjen Hoxhaj;
 5. Rregullimi i pendës dhe kanalit të ujitjes në lagjen Gacafer;
- Kryesuesi i KSHP-së ishte pjesëmarrës së bashku me përfaqësuesit e 6 komunave partnere të projektit DEMOS në Kroaci në një vizitë studimore për fushën e mobilitetit. Kjo vizitë u realizua nga 19 deri më 23 tetor 2015. Në këtë vizitë studimore vizituam komunat: Zagreb; Koprivnicë; Varazhdin; dhe Krapar;
- KSHP posedon gjithsejtë 6 procesverbale nga mbledhjet e rregullta;
- Sa i përket aspektit financiar KSHP përveç mëditjeve të anëtarëve të saj në vlerë prej 1.000,00 € për mbledhjet e rregullta (gjithsejtë katër) dhe shpenzimeve për vizitë studimore në Kroaci në vlerë prej 250,00 €, shpenzime të tjera nuk kemi.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ _____

kryesues